



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.849/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Endrit Januzaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Deç, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.849/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Endrit Januzaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Deçanit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 me të cilë ka kërkuar korrigjimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.849/2021, i ushtruar nga Endrit Januzaj Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve pas rinumërimit të votave në fshatin Isniq në klasën 0108C/03R ku dolën 18 vota plus dyshon se mund të ketë pasur manipulim duke e shfrytëzuar lëvizja ime me qene se jam në kuadër të personave me aftësi të kufizuara edhe në shkollat si Irzniq, Beleq, Prejlep dhe Deçan, si dhe votat me kusht që ishin 6 prej tyre dhe votat e diasporës. Thekson se janë disa familjarë që kanë votuar në Beleq dhe në disa fshatra të tjera ku vota e tyre mungon. Po ashtu për votat me kusht dhe votat e diasporës e paraqet veten si dëshmitar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Endrit Januzaj kërkon korrigjimin e votave në shkolla si Irzniq, Beleq, Prejlep, dhe Deçan si, votat me kusht që ishin 6 prej tyre dhe votat e diasporës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar saktë vendvotimet në të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se dyshon se ka mungesë të votave në shkollat si Irzniq, Beleq, Prejlep dhe Deçan, si dhe votat me kusht që ishin 6 prej tyre, dhe votat e diasporës, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, duke mos precizuar asnjë vendvotim dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë provë.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se ka pasur vota në vendvotimin 0108c/03R, për panelin është e qartë se në këtë vendvotim kandidati në fjalë ka pasur vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në VV e apeluar nuk ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar, prandaj u vendos si në të dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.849/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Khaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.849/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Endrit Januzaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Deç, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.849/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Endrit Januzaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Deçanit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 me të cilë ka kërkuar korrigjimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.849/2021, i ushtruar nga Endrit Januzaj Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve pas rinumërimit të votave në fshatin Isniq në klasën 0108C/03R ku dolën 18 vota plus dyshon se mund të ketë pasur manipulim duke e shfrytëzuar lëvizja ime me qene se jam në kuadër të personave me aftësi të kufizuara edhe në shkollat si Irzniq, Beleq, Prejlep dhe Deçan, si dhe votat me kusht që ishin 6 prej tyre dhe votat e diasporës. Thekson se janë disa familjarë që kanë votuar në Beleq dhe në disa fshatra të tjera ku vota e tyre mungon. Po ashtu për votat me kusht dhe votat e diasporës e paraqet veten si dëshmitar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Endrit Januzaj kërkon korrigjimin e votave në shkolla si Irzniq, Beleq, Prejlep, dhe Deçan si, votat me kusht që ishin 6 prej tyre dhe votat e diasporës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar saktë vendvotimet në të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se dyshon se ka mungesë të votave në shkollat si Irzniq, Beleq, Prejlep dhe Deçan, si dhe votat me kusht që ishin 6 prej tyre, dhe votat e diasporës, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, duke mos precizuar asnjë vendvotim dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë provë.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se ka pasur vota në vendvotimin 0108c/03R, për panelin është e qartë se në këtë vendvotim kandidati në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në VV e apeluar nuk ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar, prandaj u vendos si në të dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.849/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhatëri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.